

VENDIM
Nr.194, datë 24.2.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.191, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR VENDOSJEN E Oponencës Teknike Shtetërore për
Projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, me koncesion”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 7/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7/2. Pagesa e grupit të ekspertëve, për periudhën nga 1 janari 2010 e në vazhdim, të përballohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), nga të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit të funksioneve të saj në zbatim të vendimit nr.547, datë 9.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.”.

b) Pas pikës 7/2 shtohet pika 7/3, me këtë përmbajtje:

“7/3. AKBN-ja, nga 1 janari 2010 e në vazhdim, të planifikojë shpenzimet përkatëse për të përballuar pagesat e grupit të ekspertëve.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha